VENDM
Nr.34, datë 29.7.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli	Anëtar i " "
Zija Vuci	Anëtar i " "
Franc Jakova	Anëtar i " "
Hajredin Fuga	Anëtar i " "
Kristofor Peçi	Anëtar i " "
Kujtim Puto	Anëtar i " "
Sokol Sadushi	Anëtar i " "

me sekretare Arta Palushi, më datën 6.7.1998 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.27, Akti që i përket:

K Ë R K U E S E: Gjelina Lleshi (Domgjoni), e përfaqësuar nga avokat Ded Pali.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Natale Fran Noka
2. Liza Fran Pepa
3. Marije Fran Picaku, e përfaqësuar nga avokat Kleanthi Koçi

O B J E K T I: Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.188, datë 29.1.1997 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesja ka parashtruar si shkaqe ligjore për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit shkeljen nga kjo gjykatë të kërkesave të nenit 27 dhe 38 të ligjit "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut", që parashikojnë moscenimin e të drejtës së pronës, të trashëgimisë dhe kryerjen e procesit të rregullt ligjor, e konkretisht:

4. Gjykata e Kasacionit i ka hyrë shqyrtimit të çështjes në themel dhe ka rrëzuar kërkesë-padinë, duke kapërcyer të drejtat që ligji procedural i njeh asaj.

5. Është mohuar e drejta e trashëgimisë, sipas nenit 27 të ligjit kushtetues.

6. Janë zbatuar gabimisht dispozitat ligjore për ekonominë bujqësore, duke e trajtuar këtë truall si tokë bujqësore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesit të kërkueses, të njërit prej subjekteve të interesuara dhe përfaqësuesit të saj,

VËREN:

Shkaqet e parashtruara nga kërkuesja për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, janë të bazuara në ligj, sepse kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave themelore të sanksionuara nga dispozitat kryesore kushtetuese.

Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, duke prishur të dy vendimet e Gjykatës së Rrethit dhe të Apelit dhe rrëzuar padinë, ka tejkaluar kompetencat e tij, të parashikuara me ligj. Ai, me këtë vendim ka shqyrtuar çështjen në themel, duke analizuar provat dhe gjykuar në fakt këtë konflikt gjyqësor.

Kodi i Procedurës Civile, në nenin 485, nuk i ka dhënë të drejtën Gjykatës së Kasacionit të vendosë për rrëzimin e kërkesë-padisë, pasi një të drejtë të tillë mund ta ketë vetëm gjykata që shqyrton çështjen në fakt dhe jo Gjykata e Kasacionit, që shqyrton bazën ligjore të vendimeve gjyqësore. Arsyetimi që i ka bërë vendimit Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit është i padrejtë, sepse duke bërë analizë të provave të administruara në dosje, jo vetëm ka gabuar, por njëkohësisht i ka shtrembëruar këto prova. Kjo e bën procesin gjyqësor të parregullt. Derisa Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit ka arritur në përfundimin se të dy vendimet nuk janë të bazuara, ai duhej të vendoste prishjen e tyre dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, siç parashikojnë pikat "c" dhe "ç" të nenit 485 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo do të bënte që në rigjykim, të bëhej objekt shqyrtimi edhe vendimi i Komisionit të Kthimit të Pronave, i dalë mbi bazën e vendimeve të atakuara me rekurs, vendim ky që

njeh edhe kërkuesen, si bashkëpronarë dhe është aktualisht në fuqi.

Kjo pronë, me sipërfaqe 77 dynym, sipas notës së transkriptimit është blerë në vitin 1934 nga trashëgimlënësi Zef Gjek Noka. Me vdekjen e tij, në vitin 1936, është çelur trashëgimia ligjore dhe sipas dispozitave të kohës, trashëgimtarë të kësaj prone janë bërë fëmijët e tij, Gjelina dhe Fran Noka. Me martesën e kërkueses në vitin 1942, ajo nuk e ka humbur pronësinë. Trashëgimtarët ligjorë, pronësinë mbi këtë pasuri e kanë humbur pas vitit 1944, me ligjet që nxori pushteti i asaj kohe nëpërmjet shpronësimit.

Gjithashtu, këtë sipërfaqe toke prej 77 dynym që kërkuesja e ka fituar nga trashëgimlënësi Zef Noka, Gjykata e Kasacionit gabimisht e ka trajtuar si tokë bujqësore, kur nga të gjitha dokumentet që janë administruar në dosje, del se kjo sipërfaqe, është tokë truall, e cila me të drejtë është bërë objekt shqyrtimi nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Rrethit - Kurbin.

Arsyetimi i Gjykatës së Kasacionit që e trajton këtë sipërfaqe trualli si tokë bujqësore dhe pronë e familjes bujqësore dhe kalimi i pronës në favor të anëtarit të fundit të familjes bujqësore, duke iu referuar dispozitave të dekretit "Mbi trashëgiminë" të vitit 1954, është interpretim plotësisht i gabuar i ligjit të kohës.

Në kohën që vdes Fran Noka, në vitin 1994, i cili trajtohet nga Gjykata e Kasacionit si anëtar i fundit i familjes bujqësore, trashëgimtarëve të të cilit u mbetet pasuria, nuk vepronin dispozitat ligjore mbi familjen bujqësore.

Gjykimi në themel i kësaj çështjeje, si dhe tej kufijve të kompetencave që ligji i ka njohur Gjykatës së Kasacionit, e bëjnë procesin gjyqësor të parregullt.

Në këto rrethana, vendimi i kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, duhet të shpallet antikushtetues, sepse nga cenimi që i është bërë procesit gjyqësor, ka ardhur si pasojë mohimi i të drejtës së trashëgimisë për kërkuesen, në kundërshtim me nenet 27 dhe 38 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut".

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

VENDOSI:

Të shpallë antikushtetues vendimin nr.188, datë 29.1.1997 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.